

VENDIM
Nr.7, datë 4.1.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “ASHTË”, SI PROPOZIM I KËRKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 16 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), si propozim i kërkuar, të hidrocentralit “Ashtë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Vendimet nr.430, datë 10.12.1990 “Për miratimin e studimit të projektit të Bushatit”, nr.89, datë 19.2.1996 “Për miratimin e firmës me të cilën do të kontraktohet ndërtimi i hidrocentralit të Bushatit”, nr.586, datë 8.9.1998 “Për miratimin e firmës me të cilën do të kontraktohet ndërtimi i hidrocentralit të Bushatit dhe procedurat deri në lidhjen e kontratës” dhe nr.598, datë 13.11.2000 “Për miratimin në parim, të financimit për ndërtimin e hidrocentralit të Bushatit dhe lejin e KESH-it për prokurim të drejtpërdrejtë me kompaninë CWE”, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha